



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and
Innovation*

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B/338

Data: 08.09.2022

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojcës 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) - nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 30.03.2021, në bazë të nenit 5 paragrafi 2 të Udhëzimit administrativ të MASHTI-it Nr. 21/2016 për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve, nxjerr këtë:

THIRRJE

Për mbështetje financiare për studentët e nivelit master

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duke synuar mbështetjen e shkollimit të studentëve që janë regjistruar apo vijojnë studimet në nivelin master në top 150 universitetet më prestigjioze në botë sipas listës 'Times Higher Education' shpall këtëthirrje.

Verzioni i fundit i përditësuar i kësaj liste gjendet në linkun [Times Higher Education Ranking 2022](#)

Shuma maksimale e mbështetjes financiare është deri në 7.000 € (shtatë mijë euro) për student/e. Numri maksimal i përfituesve është 20 studentë.

Kushtet për aplikim dhe përparësitë në konkurrim:

1. Aplikantët duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Universiteti pritës të jetë në top 150 Universitetet më të mira sipas listës 'Times Higher Education'. Rangimi i universitetit në këtë listë shërben në procesin e vlerësimit;
3. Të ketë të përfunduar studimet paraprake (baçelor) në njërin nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës;
4. Thirrja vlen vetëm për studentët e nivelit master të cilët ndjekin/fillojnë studimet me prani fizike në kampusin e universitetit pritës;Për të rritur përfaqësimin e grave në mesin e studiuesve, gratë do të zgjidhen me preferencë në rastet e kualifikimit të barabartë të kandidatëve gra dhe burra.
5. Përparësi kanë aplikantët të cilët kanë gjendje më të dobët socio-ekonomike dhe ata me asistencë sociale.
6. Përparësi kanë personat me aftësi të kufizuara

7. Përparësi kanë aplikantët të cilët studimet paraprake në nivelin baçelor i kanë përfunduar në institucione publike;
8. Përparësi kanë aplikantët që studiojnë në fushat e inxhinierisë dhe të teknologjisë informative e komunikimit.

Forma e aplikimit:

Aplikimi bëhet nëpërmjet platformës online e-Kosova në linkun e shpallur në uebfaqen e MASHTI.

Dokumentet që duhet të ngarkohen në platformën e-Kosova:

1. Vërtetim nga universiteti që aplikanti/ja është në studimet master në institucionin pritës me prezencë fizike dhe orar të plotë, ku specifikohet niveli i studimeve, fusha e studimit dhe kohëzgjatja e programit (e nënshkruar dhe vulosur nga Universiteti);
2. Kopja e diplomës baçelor;
3. Transkripta e notave të studimeve baçelor;
4. Për studentët që tashmë janë duke ndjekur studimet master, transkripta e notave nga universiteti pritës (aktuale);
5. Letër motivuese për fushën e studimit dhe nevojën për mbështetjen financiare;
6. CV;
7. Dokumentet duhet të jenë të përkthyer në gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës. Dokumentet e lëshuara nga Universiteti e në gjuhën angleze janë të pranueshme
8. Nëse aplikohet, dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente për asistencë sociale dhe personave me aftësi të kufizuara sipas kushteve për aplikim dhe përparësive në konkurrim (pika 5 dhe 6)
9. Nëse aplikohet, dëshmitë relevante për gjendjen socio-ekonomike të lëshuara nga Trusti dhe ATK për aplikantin dhe prindërit (pika 5)
10. Plotësimi i fushave të aplikacionit në platformën elektronike e-Kosova është i obligueshëm.

Sqarime shtesë rreth aplikimit:

1. Në rast të pikëve të barabarta, përparësi ka aplikanti/ja në fushat me përparësi të specifikuar në këtë thirrje;
2. Aplikantët të cilëve ju mungon njëri nga dokumentet e kërkuara, diskualifikohen;
3. Nuk kanë të drejtë aplikimi kandidatët të cilët janë përfitues të ndonjë mbështetje financiare nga MASHTI apo ndonjë fomë tjetër e mbështetjes nw bashkëfinancim nga MASHTI;
4. Aplikimet pas afatit të specifikuar sipas këtij konkursi, nuk pranohen;
5. Pas përmbylljes së procesit të përzgjedhjes, aplikantët/et do të nënshkruajnë deklaratën e zotimit të përbushjes së kushteve dhe obligimeve të kësaj mbështetjeje financiare.
6. Studentët përfitues do të sjellin në MASHTI kopjen e letërnjoftimit dhe konfirmimin bankar për llogarinë personale aktive.

Afati i fundit për aplikim është data 29 Gusht 2022, ora 16.00.

